

V E N D I M
"PËR HEQJE SEKUESTRO PREVENTIVE "

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, e përbërë nga:

Gjyqtar : Adriatik Bocaj

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Ramela Skuqi** sot në Tiranë, më datë 27.12.2016, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale me Nr.Regj.**Them 1565** që i përket :

KËRKUES: **V. P. dbije e Z. dhe e M. e datelindjes 03.09.19..,banuese ne Rrug”...”,hyrja.12,shkalla.15 apartamenti 20 Tirane**

PALE E TRETE: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar me autorizim nga Prokuroria Dritan Reshka .

OBJEKTI:Heqjen e sekuestros preventive mbi te gjitha llogarite ne emerim tim

BAZA LIGJORE : Nenet 274/2 i K Pr Penale

Gjykata pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi, administroi provat dhe degjoi kerkesat perfundimtareve te paleve, te cilet kerkuan:

Kerkuesia **V. Z. P. :**

Heqjen e sekuestros preventive mbi te gjitha llogarite ne emerim tim

Prokuroria Dritan Reshka :

Rrezimin e kerkeses per heqje te sekuestros preventive .

Gjykata si e bisedioji ceshtjen ne teresi:.

VEREN

Se pala kerkuese **V. Z. P.** rezulton t'i jetë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë me anë të së cilës të neneve 274 te K.Pr.Penale kerkon:

I.Heqjen e sekuestros preventive mbi te gjitha llogarite ne emerim tim

Nga hetimi gjyqësor doli e provuar se:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane me vendimin me nr.1331 te regjistrimit date 03.11.2016 ka vendosur:

“Pranimin e kerkeses.

Vendosjen e sekuestros preventive mbi te gjitha llogarite ne emer te Shtetases V. Z. P. e datelindjes 03.09.1949.

Kundër vendimit për vënien e sekuestros cilido që ka interes mund të bëjë ankim.

Kërkesa e ankimit paraqitet brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijani për sekuestron e vënë.

Kërkesa paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin.”

Kjo sekuestro është vendosur ne baze te kerkeses se prokurorise si dhe ne baze te rrethanave te meposhtme.

Nga permbajtja e akteve te ceshtjes rezulton se Seksioni për Pastrimin e Parave ne Drejtorine Vendore te Policise Tirane ka adminsitruar te dhena lidhur me hetimin financiar te shtetase s V. Z. P., e datelindjes 03.09.19...

Rezulton se shtetasja ne fjale gjate vitit 2015 ka përfituar dy transferta në mbërritje me datë 06.10.2015 ne shumën 3,800 Euro dhe me datë 29.12.2015 shumën 1,600 Euro me urdhërues respektivisht shtetasin S. S. S. në Liban dhe nga një shoqëri e quajtur "C. R. LLC" në SHBA, të cilat i ka tërhequr cash datat 06.10.2015 dhe 07.01.2016.

Nga verifikimet në shoqërinë e transfertave Ak-Invest në lidhje me shtetasen V. P. rezulton se gjatë periudhës janar 2012 - shkurt 2016 ajo ka urdhëruar 39 transferta drejt destinacioneve të ndryshme si Anglia, Bregu i Fildishtë, Australi dhe Ganë. Ne date 13.10.2016 ka mbërritur ne favor te shtetases ne fjale nje transfertë në mbërritje ne shumën prej 18,300 USD me pale urdhëruese një shoqëri në Kinë e quajtur "Sh... Limited".

Nga ana tjeter ne adresat publike te "Alpha Bank" ka mbërritur një email i dërguar nga një subjekt i quajtur "R... S...", i cili njofton se ka marrë disa emaile nga shtetasi A. P., i cili është prezantuar si përfaqësues i shoqërisë së veshjeve "... " dhe kërkon që t'i transferohen fondet në bazë të marrëveshjes që ka me kompaninë "... " në llogarinë e me nr AL18...80, llogari e cila rezulton te zoterohet nga shtetasja V. P..

Nga kontrolli në faqen zyrtare të QKR-se nuk rezultojnë biznese të regjistruara në emër të kësaj shtetases V. Z. P. fakt që ngre dyshime mbi transaksionet e kryera apo dhe te tentuara per t'u kryer favor të saj.

Ne te tilla rrethana nisur nga transfertat e përfituara nga shtetasja V. P. me urdhërues shoqëri imobiliare nga Libani, me të cilat nuk rezultojnë kontrata noteriale të raportuara apo marrëdhënie biznesi, fluksi i transfertave të transferuara nga V. P. drejt shtetasve të ndryshëm në vlera relativisht të konsiderueshme nëpërmjet shoqërisë së transfertave "Ak-Invest", shfrytëzimi i llogarisë bankare të shtetases V. P. nga shtetas të huaj sipas korrespondencës së email it për pagesen e vleres se nje malli te porositur si edhe transferta në mbërritje nga një shoqëri kineze me përfitues shtetasen V. P. jo si individ, por me të dhëna të tjera bashkëlidhur "V. P. A. Group L. L. C" ndërkohë që nga faqja zyrtare e QKR-se nuk rezultojnë biznese të regjistruara krijohen dyshime për aktivitetin e kësaj shtetase si edhe dyshime te arsyeshme ekzistencen e elementeve te vepre s penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale", te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Kerkuesia ne seance nuk solli asnje prove qe te provonte dhe te krijonte bindje per gjykatën per te hequr sekuestron preventive.

Nga ana tjetër prokurori kerkoji qe kërkesa e kerkuses te rrezohet sepse ne lidhje me çfarë prokuroria po heton nuk ka ndryshuar asnje rrethane qe nga koha e dhenies se mases per vendosje te sekuestron preventive e deri me sot dhe ekzistojne akoma dyshime te arsyeshme ekzistencen e elementeve te vepre s penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale", te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Në nenin 274/2 të Kodit te Procedure s Penale parashikohet se sekuestroja preventive mund të vendoset për çdo pasuri që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të Kodit Penal. Ne te tilla rrethana eshte e nevojshme vendosja e sekuestron preventive mbi pasurine e pershkruara me lart duke qene se disponimi i lire i saj mund te rendojë dhe zgjase pasojat e vepres penale për të cilën është regjistruar ky procedim penal duke sjelle tjetersimin ose transferimin e tyre tek persona te trete , e bazuar sa siper gjykata cmon se kërkesa e kerkuses V. P. duhet rrezuar. Sa siper u provua nga theniet e kerkuses te prokurorit dhe provat e administruara ne séance gjyqesore.

PER KETO ARSYE

Gjyakata e bazuar ne nenin 274 te K.Pr.Penal

V E N D O S I

Rrezimin e kerkeses se kerkuses V. Z. P. si te pa bazaur ne prova e ne ligj.

Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda afati 10 ditor duke filluar nga e nesermja e shpalljes se vendimit..

U shpall sot më datë 27.12.2016, në Tiranë.

SEKRETARE

Ramela Skuqi

GJYQTAR

Adriatik Bocaj